



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Korçë, më 05/12/2017

TAKIM PËR BUXHETIMIN ME PJESËMARRJE ME BANORËT E NJËSISË  
ADMINISTRATIVE MOLLAJ

Bazuar në Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në vijim të procesit të përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2018, zhvilluam një takim në datë 05/12/2017 me banorët e Njesisë Administrative Mollaj.

Në takim morën pjesë: Zv/Kryetari i Bashkisë Ermal Saraçi, staf i bashkisë, banorë të njësisë administrative Mollaj dhe organizata të tjera të interesuara, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku ata jetojnë.

Gjatë takimit, banorët sollën në vëmendje dhe shqyrtuan së bashku disa kërkesa dhe problematika të zonës, të cilat janë të listuara si më poshtë:

- Sistemim të argjinaturës së lumit në fshatin Dvoran.
- Rikonstruksionin e kanalizimeve të ujrave të zeza në fshatin Dvoran.
- Sistemimi i rrugës në lagjen lart të fshatit Kamenicë.
- Riparim i linjës së furnizimit me energji elektrike në fshatin Kamenicë.
- Vazhdimi i punimeve të rrugës në fshatin Pulahë.
- Rehabilitimin dhe sistemimin e rrugëve të brendëshme në fshatin Floq.
- Rehabilitimin e ujësjellësit në fshatin Floq.
- Heqjen e bagëtive nga fshati Dvoran.

**Buxheti me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit.**









